REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1904/11 Prot Tiranë më 26.10 2020

VENDIM
Nr. 21, datë 21.10. 2020

"PËR
MIRATIMIN PARAPRAK TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023 PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS"

Në mbështetje të:

- Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma h);
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjit nr.88/2019, date 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020";
- Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022" ;
- Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm";
- Ligjit nr.10.296 datë 08.07.2010 "Për Manaxhimin Financiar dhe Kontrollin";

Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.10. 2020 mori në shqyrtim dhe diskutoi materialin e paraqitur nga Administratori i UT-së " PBA 2021-2023 për Universitetin e Tiranës". Senati Akademik duke konstatuar se në këtë material janë marrë në konsideratë kërkesat e njësive shpenzuese,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 në përputhje me tavanet ligjore të shpenzimeve, sipas formularëve të paraqitur.

2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të UT-së për miratim të mëtejshëm në përputhje me nenin 49, pika 1 ,gërma c) të ligjit nr.80/2015 datë 22.07.2015.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR. ARTAN HOXHA